



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit
SJ-028
Prishtinë, më 20 prill, 31 maj dhe 4 qershor 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 20 PRILL, 31 MAJ DHE 4 QERSHOR 2018**

Seancën e kryesoi kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, i ndihmuar nga Xhavit Haliti dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryesuesi i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së 40 deputetëve të Kuvendit, me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, mbështetur nga 40 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës.

Më pas, kryesuesi e ftoi deputeten Fitore Pacolli që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Deputetja Fitore Pacolli tha se Raporti për vendin nuk duhet të trajtohet vetëm si një dokument, i cili skanon dhe paraqet gjendjen e rëndë në të cilën gjendet shteti ynë, por si një dokument përmes të cilit ne duhet seriozisht të shqyrtojmë rrugën dhe marrëdhënien kontraktuale shtetërore të Kosovës me Bashkimin Evropian.

Pastaj, ajo tha se në vend që përqendrimi ynë të ishte tek rruga jonë drejt BE-së, personat që edhe sot mbajnë pozitat kyçe në vend, bartën tërë fokusin në organizimin e dialogut me Serbinë dhe kështu zbehën edhe vendimin pozitiv për pavarësinë e Kosovës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Dhe është pikërisht kjo qasje, e cila po vazhdon të mbizotërojë edhe sot, që ka ndikuar që Kosova të jetë këtu ku është. Shtetet të cilat ishin përkrahëset më të mëdha të pavarësisë së Kosovës nuk bëjnë më as thirrje te 5 shtetet e BE-së që ta njohin Kosovën, edhe pse mosnjohja nga 5 shtetet anëtare mbetet pengesë serioze dhe e pakapërcyeshme për Kosovën në realizimin e aspiratës së saj drejt integritetit evropian.

Në vazhdim, deputetja Fitore Pacolli tha se strategjia e BE-së për zgjerim të Ballkanit Perëndimor definoi rrugët e strukturuar që duhet të ndjekin shtetet veç e veç për të avancuar drejt integritetit evropian, por Kosova u trajtua vetëm si mjet nëpërmjet të cilit i hapet rruga Serbisë. Përderisa Serbisë iu bë e qartë se normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën do t'i sigurojë anëtarësimin në BE, Kosovës iu tha se duhet të vazhdojë të jetë e përkushtuar në dialog, sepse edhe Kosova përfiton nga normalizimi, por nuk u tha se çka. Pra, Kosova në këtë strategjinë e Bashkimit Evropian mbetet pjesë e dokumentit, por nuk është pjesë e strategjisë së zgjerimit.

Më pas, ajo në nëntë pika i paraqiti të gjeturat e Raportit për vendin duke i krahasuar me raportet e viteve paraprake dhe për të konstatuar se gjendja për çdo vit është përkeqësuar. Diskutimi i plotë i znj. Fitore Pacolli, është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin lidhur me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës.

Lidhur me Raportin për vendin diskutuan deputetët: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Blerta Deliu-Kodra, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP Nisma; Ilir Deda, Hajdar Beqa, Arbër Rexhaj, Besa Baftiu, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Haxhi Avdyli, Mirjeta Kalludra, Albulena Haxhiu, Driton Çausi, Muharrem Nitaj, Vjosa Osmani, Mexhide Mjaku-Topalli, Sami Kurteshi, Dukagjin Gorani, Korab Sejdiu, Fatmire Kollçaku, Shqipe Pantina, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Ali Lajçi, Visar Ymeri, Driton Selmanaj, Rexhep Selimi, Lumir Abdixhiku, Arbërie Nagavci, Ismajl Kurteshi, Liburn Aliu, Drita Millaku, Xhelal Sveçla, Saranda Bogujevci, Adem Mikullovc, kryeministri Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, ministrat Dhurata Hoxha, Abelard Tahiri dhe Bajram Hasani, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund të debatit, kryesuesi e ftoi deputeten Fitore Pacolli që t'i paraqesë rekomandimet për miratim.

Deputetja Fitore Pacolli, në emër të GP të LVV dhe GP të LDK-së, i paraqiti 11 rekomandime.

Meqë nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, kryesuesi nuk i hodhi në rekomandimet e propozuara.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës së jashtëzakonshme në orën 18:30.

Vazhdimi i seancës, më 31 maj 2018

Në fillim të seancës, deputetja Fitore Pacolli, në emër të GP të LVV dhe GP të LDK-së, propozoi që për tekstin e Propozim-rezolutës të harmonizohet edhe me grupet e tjera parlamentare. Në ndërkohë, grupet parlamentare e caktuan nga një përfaqësues për ta harmonizuar tekstin e Propozim-rezolutës.

Në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës së jashtëzakonshme.

Vazhdimi i seancës, më 4 qershor 2018

Kryetari e ftoi deputeten Fitore Pacolli, që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë tekstin e Propozim-rezolutën për miratim.

Deputetja Fitore Pacolli, në emër të GP të LVV dhe GP të LDK-së, e paraqiti dhe e arsyetoi Propozim-rezolutën prej 13 pikave.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Propozim-rezolutën e paraqitur nga znj. Pacolli.

Rezultati i votimit ishte:

Për..... 37 vota,
Kundër.....41 vota,
Abstenime... 2 vota.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi Propozim-rezolutën në lidhje me Raportin për vendin, të propozuar nga grupet parlamentare të LVV-së dhe LDK-së.

Kryetari e mbylli seancën e jashtëzakonshme në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale